



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit: 23.8n.1-2016-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT  
PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË KOMPANISË  
RAJONALE TË MBETURINAVE PASTËRTIA SH.A. FERIZAJ  
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016**

**Prishtinë, maj 2017**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave Pastërtia Sh.A. Ferizaj, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Mehmeti* e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga *Ganimete Dalloshi Udhëheqëse Ekipi dhe Valmira Jonuzi*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

## TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	6
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	16
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit .....	28
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	29
Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak .....	32
Shtojca IV: Letër konfirmimi .....	34

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Kompanisë Rajonale të Mbeturinave Pastërtia Sh.A. Ferizaj (me tutje Pastërtia) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit<sup>1</sup>, të datës 23/11/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Pastërtisë.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

#### Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Pastërtisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër.


Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

<sup>1</sup> Termi “Plani i Jashtëm i Auditimit” është zëvendësim i termit “Memorandumi i Planifikimi të Auditimit”

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



### Përgjigja e Kryesuesit të Bordit – auditimi 2016

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do të adresoj rekomandimet e dhëna.

---

# 1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

## Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

## 1.1 Opinioni i auditimit

### Opinion i kundërt

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Pastërtisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

### Baza për opinion të kundërt

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kundërt, për arsyet e përmendura në vijim:

- Regjistrim i njëanshëm i transaksioneve. Secila ngjarje në kontabilitet duhet të regjistrohet në librat e llogarive edhe si një debitim edhe si një kreditim por me shenjë të kundërt, e që ndryshe quhet koncepti i dyfishtë. Gjatë vitit 2016, Pastërtia kishte bërë faljen e borxheve në vlerë 289,308€, kjo ka shkaktuar zvogëlim (kreditim) të Llogarive të arkëtueshme, mirëpo një gjë e tillë nuk ishte përcjell me regjistrim në anën debi si njohje e provizionit për borxhet e këqija. Një regjistrim i njëanshëm shkaktonte nënvlerësim të fitimit/humbjes, rrjedhimisht mos barazim të bilancit të gjendjes;

- Në PVF-të e vitit 2015, Pastërtia kishte prezantuar detyrime tjera afatshkurtra në vlerë prej 662,597€, mirëpo nuk ekzistojnë shënime kontabël lidhur me përbërjen e kësaj vlerë. Për me tepër në vitin 2016, nuk ishte prezantuar asnjë vlerë si detyrime tjera afatshkurtra dhe nuk ekzistojnë shënime kontabël nëse këto detyrime janë paguar gjatë vitit 2016.
- Prezantim jo i saktë i aseteve. Pastërtia për vite me radhe kishte aplikuar norma të ndryshme të zhvlerësimit të cilat nuk ishin në përputhje me normat e zhvlerësimit sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) ose sipas SNK-ve. Pas rekomandimeve tona në fazën e ndërmjetme të auditimit Pastërtia kishte filluar aplikimin e normave adekuate të zhvlerësimit. Mirëpo, përkundër kësaj, vlera neto në libra e cila bartet nga vitet e kaluara nuk është e saktë për shkak të aplikimit të normave jo adekuate të zhvlerësimit;
- Prezantim jo i saktë i kapitalit rezervë. Vlera e kapitalit rezervë e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 418,273€ në krahasim me shënimet kontabël. Në PVF kjo rezervë ishte prezantuar 2,506,719€, ndërsa në shënimet kontabël saldo e kësaj llogarie është 2,088,446€. Një mbivlerësim i tillë ishte bërë me qëllim të barazimit të bilancit të gjendjes;
- Mos rivlerësimi i pasurive jo-qarkulluese. Sipas SNK 36 së paku një herë në 3 deri 5 vite duhet të bëhet rivlerësimi i pasurive. Pastërtia që nga viti 2007 nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos njohurive të standardit përkatës;
- Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për disa nga zërat e prezantuara në pasqyrat financiare vjetore, për më detaje shih nënkapitullin 3.7;
- Mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe letër konfirmimeve nga furnitorët. Në një letër konfirmim të pranuar nga furnitori janë vërejtur mospërputhje me shënimet kontabël. Shuma e borxhit e konfirmuar nga furnitori është 307,497€, ndërsa në shënimet kontabël vlera e borxhit ndaj këtij furnitori është 273,066€, duke rezultuar me një nënvlerësim prej 34,431€. Kjo ka ndodhur si pasojë e regjistrimeve jo të sakta dhe mos harmonizimeve me furnitorët;
- Prezantim jo i saktë i llogarive të arkëtueshme. Vlera e llogarive të arkëtueshme të prezantuar në PVF e vitit 2016, paraqet një vlerë jo të saktë pasi që saldo fillestare e cila bartet nga viti i kaluar ishte provizionuar për 176,028€ pa ndonjë kriter apo politike për provizionim;
- Prezantim jo i drejtë i shpenzimeve. Shpenzimet financiare përbëhen nga pagesat për kompensim të komisionit komunal të aksionarit sipas një vendimi të nxjerr nga Kuvendi Komunal i Ferizajit, vendim i cili sipas Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL) është pa bazë ligjore. Shuma e paguar për këto kompensime ishte 22,680€. Një gjë e tillë ka rritur shpenzimet pa bazë ligjore. Për me tepër këto shpenzime ishin prezantuar si shpenzime financiare; dhe
- Mos numërimi i stoqeve në fund të vitit. Vlera e stoqeve e prezantuar në PVF është 27,689€. Sipas Ligjit të ATK-së<sup>2</sup>, çdo tatimpagues kërkohet të bëjë dhe mbajë regjistrimin e mallrave në stoqe në fund të vitit kalendarik. Pastërtia nuk kishte bërë vlerësimin dhe regjistrimin e

<sup>2</sup> Ligji Nr. 03/L22 Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat (neni 13).

---

stoqeve në fund të vitit, kjo për shkak se nuk kishin krijuar komision për regjistrim. Ekziston rreziku që vlerat e prezantuara në pasqyra financiare të mos jenë në përputhje me gjendjen faktike të stoqeve.

Çështjet e prezantuara me lartë rezultojnë me prezantim jo të saktë të PVF-ve. Kjo për shkak të dobësive në funksionimin e kontroleve të brendshme, me theks të veçantë në sistemet e kontabilitetit dhe financave.

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Pastërtia dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

### **Çështje Të tjera**

Pasqyrat financiare vjetore të Pastërtisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pa modifikuar.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Kryesuesi i Bordit të Pastërtisë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit aktual të kontabilitetit. Si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse PVF në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga



mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## 1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Ndërmarrjeve Publike (NP) i 'u kërkohet të veprojnë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime); dhe
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore.

Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisin:

- Statutin e NP-së;
- Planin e Biznesit;
- Raportet tremujore;
- Raportin vjetor;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në Memorandumin tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/12/2016, ne kemi ngritur disa çështje në lidhje me pasqyrat financiare të cilat mund të kenë ndikim edhe në opinion. Çështjet e ngritura nuk ishin adresuar. Si pasojë, në draft pasqyrat financiare vjetore të datës 21/02/2017 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Përkundër sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, Pastërtia kishte bërë vetëm disa korrigjime në pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, nuk mund të konsiderohen të sakta për shkak se janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, Pastërtia kishte përmbushur kërkesat e lartshënuara, përveç raportit për matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve e cila nuk ishte përfunduar ende.

### 1.3 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

**Rekomandimi 1** **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejtë dhe të vërtetë të tyre.

**Rekomandimi 2** **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit gjithashtu duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. PFV-të duhet të aprovohen nëse ndaj draftit të tyre janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

---

## 2 Qeverisja

### Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Pastërtinë që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesëve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Prandaj, kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për të përcaktuar cilësinë e raporteve të ndryshme të njësive individuale dhe të NP në përgjithësi.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, ndarjes së detyrave, përmbushjen e kërkesave (kënaqëshmërisë) të konsumatorëve; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë zbrazëtira në aranzhimet ekzistuese të qeverisjes në Pastërtia siç janë: mos përcaktimi i afateve kohore lidhur me synimet afariste dhe financiare dhe mos prezantimi i burimeve të të hyrave në planin e biznesit, sistemi i auditimit të brendshëm nuk është plotësisht efektiv në forcimin e kontrolleve të brendshme. Këto fusha duhet të rishikohen si dhe të ndërmerren veprime konkrete për adresimin e tyre.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i Pastërtisë duke implementuar pjesën më të madhe të rekomandimeve. Ky është një tregues që Pastërtia është munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe t'i forcoj kontrollet në disa fusha.

Pastërtia kishte të miratuar planin e biznesit për vitin 2016, por ky nuk përmban afatet kohore për realizimin e synimeve afariste dhe financiare. Gjithashtu, plani nuk përmban edhe mënyrën e financimit të shpenzimeve, gjegjësisht burimet e të hyrave.

Më tej, sistemi i auditimit të brendshëm si hallkë kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur me vlerësimin e kontrolleve të brendshme të Pastërtisë.

---

Audtimi i brendshëm kishte nxjerr pesë raporte. Sipas auditorit të brendshëm një raport përmban dy e më shumë tema të planifikuara të auditimit. Rishikimet tona konstatojnë se në këto raporte nuk mund të bëhet identifikimi i temave të trajtuara të auditimit. Gjithashtu raportet e auditimit ishin më shumë përshkruese, duke mos ofruar asnjë konkluzion dhe rekomandim për përmirësim.

## 2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti i auditimit të jashtëm<sup>3</sup> për PFV-të të vitit 2015 të Pastërtisë ka rezultuar në tetë (8) rekomandime kryesore. Pastërtia kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra e zbatimit të të gjitha rekomandimeve. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar tërësisht, dy (2) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa një (1) rekomandim nuk ishte zbatuar fare. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

### Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- Rreziku** Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve të auditimit, Pastërtia ende nuk ka arritur të zbatoj plotësisht dy (2) rekomandime si dhe një (1) rekomandim me ndikim në opinion nuk ishte zbatuar fare. Kjo, sepse Pastërtia nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm.
- Rreziku** Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me pasqyrat financiare vjetore.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatimin e planit të veprimit, i cili i përcakton afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të shqyrtohen me drejtorët relevant dhe të raportohen tek Kryeshefi Ekzekutiv.

<sup>3</sup> Raporti i auditimit të jashtëm - Auditimin e PFV të Pastërtisë për vitin 2015 e kishte bërë një kompani private audituese dhe jo ZKA, dhe raportimi i tyre ka përfshirë një raport me opinionin dhe një letër për menaxhmentin ku janë prezantuar të gjeturat me rekomandimet.

## 2.2 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Pastërtia operon dhe sfidat me të cilat përballet.

### 2.2.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Korniza ligjore, kërkon që Ndërmarrjet Publike të hartojnë Planin e Biznesit, plan i cili duhet të miratohet nga Bordi i Drejtorëve brenda afatit kohor ligjor.

#### Çështja 4 - Dobësi në përmbajtjen e Planit të Biznesit - Prioritet i lartë

<b>E gjetura</b>	<p>Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me përmbajtjen e Planit të Biznesit si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pastërtia kishte hartuar Planin e Biznesit për vitin 2016 dhe miratuar nga Bordi i Drejtorëve brenda afatit kohor ligjor. Plani përmban synimet afariste dhe financiare të cilat Pastërtia synon ti arrij gjatë vitit 2016 si dhe qasjen për realizimin e këtyre synimeve. Mirëpo, plani nuk përmban afatet kohore për realizimin e këtyre synimeve; dhe</li> <li>• Korniza ligjore kërkon që Ndërmarrja Publike të hartoj Planin e Biznesit duke përcaktuar shpenzimet e përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë si dhe mënyrën për financimin e shpenzimeve. Plani i Biznesit përmban shpenzimet e përgjithshme për ushtrimin e veprimtarisë, mirëpo nuk përmban mënyrën e financimit të këtyre shpenzimeve, gjegjësisht burimet e të hyrave. Plani i Biznesit përmban vetëm të hyrat e përgjithshme në total. Mirëpo nuk dihet nëse këto të hyra do jenë nga shërbimet që i ofron Pastërtia apo nga ndonjë burim tjetër i financimit.</li> </ul>
<b>Rreziku</b>	<p>Mungesa e afateve kohore për realizimin e synimeve, bën të pamundur që të përcjellët përmbushja e tyre në pikëpamje të afatit kohor, kur këto synime duhet të realizohen. Gjithashtu, mos përcaktimi i burimit të të hyrave në planin e biznesit mund të ndikoj në realizimin dhe rishikimin e planit për të hyrat, e rrjedhimisht edhe për shpenzimet.</p>
<b>Rekomandimi 4</b>	<p>Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Plani i Biznesit krahas synimeve afariste dhe qasjes për realizimin e tyre të përmbajë edhe afate kohore për realizimin e tyre. Gjithashtu duhet të sigurojë që gjatë përpilimit të Planit të Biznesit të përcaktohet edhe burimi i të hyrave të planifikuara.</p>

---

## 2.2.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

---

### Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

- E gjetura** Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të Pastërtisë ka nxjerrë në pah se linjat e llogaridhënies dhe komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta dhe raportimit me shkrim. Mirëpo, pavarësisht kësaj, në shumë fusha kontrollet e brendshme nuk janë aplikuar në mënyrë efektive dhe nuk kanë arritur t'i parandalojnë gabimet gjatë vitit. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, pasurive jo qarkulluese, stoqet, realizimin e shpenzimeve, menaxhimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e pagesave pa certifikim, kategorizim jo të duhur të shpenzimeve dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave.
- Rreziku** Mos aplikimi i kontrolleve në mënyrë efektive ka reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda Pastërtisë. Kjo gjithashtu mund të rezultojë me të dhëna jo të sakta financiare.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë këto dobësi.

---

## 2.3 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me një staf i cili njëherit është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Pastërtisë dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve, si dhe nga mbështetja dhe sfida të ofruara nga një Komitet efektiv Auditimi.

---

### Çështja 6 - Mangësitë në funksionimin e NjAB - Prioriteti i lartë

- E gjetura** NjAB kishte përgatitur planin vjetor në përputhje me planin strategjik dhe për vitin 2016 kishte planifikuar 15 auditime, prej të cilave janë kryer pesë (5) auditime. Sipas Auditorit të Brendshëm në një raport janë trajtuar dy e më shumë tema të planifikuara të auditimit. Rishikimet tona konstatojnë se në këto raporte nuk mund të bëhet identifikimi i temave të trajtuara të auditimit. Gjithashtu, raportet e auditimit ishin më shumë përshkruese, duke mos ofruar asnjë konkluzion dhe rekomandim për përmirësim. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos orientimit të punës së auditimit të brendshëm në përmirësimin e sistemit financiar dhe kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes jo adekuate nga Komiteti i Auditimit
- Rreziku** Një plan jo adekuat i auditimit dhe raporte pa konkluzione dhe rekomandime nuk e ndihmojnë menaxhmentin lidhur me funksionimin e sistemeve financiare dhe të kontrolleve të brendshme. Kjo mund të rezultojë me dobësi të paidentifikuara dhe me vazhdimin e praktikave jo efektive duke pasur parasysh se nuk jepen rekomandimet për të evituar dobësitë në ndërmarrje.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit rishikon në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik për t'i ofruar sigurinë e kërkuar menaxhmentit dhe secili auditim i kryer të rezultojë me raporte individuale të auditimit. Më tutje, Komiteti i Auditimit duhet të siguroj që cilësia e raporteve të auditimit është rritur, me theks të veçantë raportet e auditimit duhet të kenë konkluzionet dhe rekomandimet për të adresuar problemet me të cilat ballafaqohet Pastërtia.

---

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në NP. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Pastërtisë kanë nevojë për përmirësime të mëtutjeshme. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate, ato nuk kanë marrë në konsideratë shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit që rrezikojnë Pastërtinë në mos arritjen e objektivave dhe pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve. Gjatë vitit 2016, Pastërtia ka operuar me humbje në vlerë prej 51,656€. Në këtë rezultat financiar, si dhe në veprimtarinë e Pastërtisë në tërësi, ndikim të rëndësishëm kishte rritja e numrit të punësuarve, zvogëlimi i të hyrave, rritja e pagave, vendimi i kuvendit komunal për pagesën e anëtareve të komisioneve komunale.

Duke pasur parasysh këto, gjendja e tanishme, pa një bazë reale për të gjetur një zgjidhje adekuate në kapërcimin e saj dhe në rritjen e aktiviteteve dërgon në një situatë ku vihet në rrezik vijimësia e ndërmarrjes.

Ekzekutimi i pagesave të shpenzimeve të pa certifikuara, planifikimi jo i detajuar i të hyrave, mos përcaktimi i tarifave të shërbimit nga organet kompetente. Po ashtu, edhe proceset ekzistuese në menaxhimin e pasurisë duhet të rishikohen me theks të veçantë mënyra e trajtimit të pasurive në regjistrat kontabël.

Më tutje, proceset e rekrutimit të punonjësve nuk ishin menaxhuar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Angazhimi i punonjësve pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues, mos njoftimi me shkrim i aplikantëve, e minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin tek Pastërtia.



### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në këtë pjesë shqyrtojmë burimet e fondeve buxhetore për Pastërtinë, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e realizuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Kategoritë ekonomike të planifikuara dhe të realizuara në €**

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2016	Planifikimi i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
1	Të hyra	1,569,425	1,569,425	1,577,603	1,611,683
2	Shpenzimet	1,400,191	1,400,191	1,629,260	1,599,765 <sup>4</sup>
3	Humbja (1-2)	169,234	169,234	(51,656)	11,918

Të hyrat e prezantuar me sipër, përfshijnë të hyrat nga aktiviteti i ndërmarrjes.

Sa i përket shpenzimeve, vlera e prezantuar në tabelën me sipër prezanton të gjitha shpenzimet e realizuara gjatë vitit duke përfshirë edhe shpenzimet e zhvlerësimit.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit në €**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2016 Realizimi	2015 Realizimi
<b>Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>1,400,191</b>	<b>1,400,191</b>	<b>1,629,260</b>	<b>1,598,442</b>
Pagat dhe Mëditjet	838,367	838,367	905,519	767,826
Mallrat dhe Shërbimet përfshirë komunalit	561,824	561,824	631,927	762,286
Shpenzimet e zhvlerësimit	0	0	91,814	68,329

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

Gjatë vitit 2016, Pastërtia kishte planifikuar investime kapitale në vlerë prej 1,219,646€, mirëpo si rezultat i mos ndarjes së granteve nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) dhe për shkak të gjendjes financiare nuk kishte realizuar asnjë projekt kapital.

Realizimi i buxhetit për paga dhe mëditje krahasuar me planifikimin ishte tejkaluar për 67,152€, ndërsa në raport me vitin e kaluar kishte rritje të shpenzimeve për 137,693€, respektivisht 15%.

Shpenzimi i buxhetit për kategorinë Mallra dhe Shërbime përfshirë komunalitë në raport me planifikimin ishte tejkaluar për 70,103€, ndërsa në raport me vitin e kaluar shuma e shpenzuar ishte me i ulët për 130,359€, respektivisht 21%.

<sup>4</sup> Shuma e shpenzimeve përfshin edhe tatimin në fitim

**Çështja 7 – Mangësitë në planifikimin e buxhetit – Prioriteti i lartë****E gjetura**

Sa i përket planifikimit të buxhetit janë vërejtur mangësitë si në vijim:

- Të kategoria paga dhe mëditje gjatë planifikimit nuk ishin marr parasysh rritjet e numrit të stafit të cilat kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe ngritja e pagave të një pjese të punëtorëve me vendimin e Bordit të Drejtoresve. Këto kanë shkaktuar tejkalim të buxhetit në raport me planifikimin e buxhetit.
- Të kategoria e mallrave dhe shërbimeve gjatë planifikimit nuk ishin marrë parasysh rritja e tarifës për deponim të mbeturinave dhe e shpenzimeve administrative si nuk rritjes së numrit të stafit. Këto kanë shkaktuar tejkalim të shpenzimeve të planifikuara.

**Rreziku**

Planifikimi jo i duhur i buxhetit dhe tejkalimi i tij do të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe në financimin e detyrimeve të vitit aktual nga buxhetet e vitit të ardhshëm.

**Rekomandimi 7**

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar. Aty ku planifikimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, duhet të reflektohet me rishikim të buxhetit.

## 3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Pastërtia në 2016 ishin në vlerë 1,577,604€. Ato kanë të bëjnë me ofrimin shërbimeve për grumbullimin, transportimin dhe heqjen e mbeturinave në komunën e Ferizajit, Kaçanikut dhe Shtimes.

**Tabela 3. Të hyrat e planifikuara dhe realizuara në €**

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2016	Buxheti final 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Të hyrat	1,569,425	1,569,425	1,577,604	1,611,683

Pastërtia kishte arrite që ta realizoj planin vjetor për të hyrat, madje duke e tejkeluar për 0.5% për vitin 2016, por përkundër kësaj kishte një realizim më të ulët për 2% krahasuar me vitin paraprak.

---

**Çështja 8 - Planifikim jo i detajuar i të hyrave - Prioriteti i lartë**

- E gjetura** Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë të pritshmërive në realizimin e të hyrave, duhet të përgatitet një plan i detajuar ku përshkruhen pritjet për realizim bazuar në secilin lloj të të hyrave. Pastërtia kishte planifikuar të hyrat vetëm në total, mirëpo nuk kishte hartuar një plan detaj i cili do të bazohej në të gjitha llojet e të hyrave që realizohen nga Pastërtia.
- Rreziku** Mungesa e një planifikimi të mirëfilltë të të hyrave rrit rrezikun që të mos realizohen të hyrat sipas planit dhe kjo gjithashtu ndikon në mos realizimin e projekteve të planifikuara për t'u realizuar nga të hyrat vetanake.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që planifikimi i të hyrave të bëhet bazuar në një analizë të mirëfilltë për të gjitha llojet e të hyrave të cilat priten të realizohen.

**Çështja 9 - Mangësi në pajtueshmërinë me ligjin për mbeturinat - Prioriteti i lartë**

- E gjetura** Nga qershori 2012, me ndryshimin e Ligjit për mbeturinat (neni 14.3 dhe 15) Tarifat për deponimin e mbeturinave komunale i caktojnë Komunat. Komuna cakton tarifat dhe mënyrën e inkasimit të mjeteve financiare për shërbimet komunale. Pastërtia shërbimet e saj i ofron duke u bazuar në urdhëresën për tarifa shërbimi të përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit të Ujit dhe Mbeturinave urdhërese e cila ka qenë në fuqi për periudhën 1 Qershor 2011 deri me 31 Maj 2012. Edhe përkundër përpjekjes së Pastërtisë drejtuar Komunës, si kompetente për caktimin e tarifores sipas ligjvënësit, faturimi i të hyrave vazhdon me të njëjtën bazë duke i shtuar edhe Tatimin e Vlerës së Shtuar prej 8%.
- Rreziku** Mos përcaktimi i tarifave të shërbimit nga organet kompetente sjell deri të mos zbatimi i procedurave ligjore dhe shkakton një kosto jo të sakte të shërbimit, kjo rrjedhimisht ndikon edhe në fitimet/humbjet e ndërmarrjes.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që mos pajtueshmëritë ligjore të korrigjohen sa më shpejt që është e mundur duke aplikuar tarifa shërbimi të caktuara nga Komuna si organ kompetent.

### 3.2.1 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes llogarisë bankare të Pastërtisë dhe kalkuloohen nga programi i kontabilitetit të sajë. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave të pagave sigurohen nga sistemi i kontrolleve të brendshme.

Numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 205 punonjës dhe 4 anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat nga shënimet kontabël dhe prezantimin e tyre në PFV.

#### Çështja 10 - Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore- Prioritet i lartë

**E gjetura** Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Sipas Ligjit të Punës (neni 8), Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Gjatë vitit 2016, Pastërtia kishte angazhuar katër punonjës për punë dhe detyra specifike, mirëpo këta punonjës mbulonin pozitat e rregullta të punës dhe për të cilët nuk kishte zhvilluar procedurë të rekrutimit;
- Sipas Udhëzimit Administrativ (UA) për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në Sektorin Publik (neni 5.2), për fillimin e procedurave të rekrutimit duhet të jenë së paku tri aplikacione që i plotësojnë kushtet sipas konkursit. Në tri procese rekrutimi, komisionet për rekrutim kanë konstatuar se nga të gjithë kandidatët që kanë aplikuar, nuk arrin në tre numri i atyre që i plotësojnë kriteret e konkursit, duke specifikuar se nuk i kanë përmbushur kriteret e konkursit, ndërsa Pastërtia kishte vazhduar me procesin e rekrutimit duke i punësuar kandidatet e suksesshëm.
- Dobësi gjatë procesit të rekrutimit. Sipas Udhëzimit për Marrëdhënien e Punës (neni 5), kandidatët e përzgjedhur duhet të ftohen me shkrim së paku 48 orë para testimit. Në pesë procese të rekrutimit aplikantët nuk ishin ftuar me shkrim për t'iu nënshtruar testit ose intervistës. Sipas zyrtarit të burimeve njerëzore, të gjithë aplikantët ishin ftuar vetëm përmes telefonit; dhe
- Sipas Udhëzimit për Marrëdhënie të Punës (neni 5), kandidati i cili fiton më së shumti pikë nga numri i përgjithshëm i pikëve (me shkrim dhe me gojë) përzgjidhet nga komisioni intervistues. Në pesë procese të rekrutimit, për pesë pozita të ndryshme, nuk kishte dëshmi që është realizuar testimi me shkrim dhe intervistimi i kandidatëve. Përzgjedhja ishte bërë vetëm nga rekomandimi i komisionit për rekrutim.

**Rreziku** Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit, mos njoftimi i kandidateve me shkrim, mos realizimi i testimit dhe intervistës si dhe angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës si dhe pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

**Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë mangësitë e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të stafit të ri, gjithashtu pozitat me përgjegjësi operationale duhet të ushtrohen nga zyrtarët/punonjësit me kontrata të rregullta të punës.

### 3.2.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 561,824€. Prej tyre ishin shpenzuar 631,927€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime operative, shpenzime administrative dhe shpenzime komunale të Pastërtisë.

#### Çështja 11 – Pagesa në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrje Publike – Prioritet i lartë

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, (neni 20), pagesa e honorarëve bëhet vetëm për drejtorët e Ndërmarrjes Publike lokale me një vendim të komisionit përkatës komunal të aksionarëve. Kuvendi Komunal i Ferizajit në vitin 2014 kishte nxjerr një vendim në të cilin e ka obliguar ndërmarrjen Pastërtia për kompensimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve (KKA). Po ashtu në një vendim tjetër të vitit 2015 kishte obliguar Pastërtinë që në mënyrë retroaktive të bëjë kompensimin e anëtarëve të KKA-së edhe për përbërjen e komisionit të kaluar. Në vitin 2015, Pastërtia kishte bërë kërkesë për interpretim në MAPL, lidhur me ligjshmërinë e këtij vendimi, ku sipas kësaj të fundit ky vendim i miratuar nga Kuvendi Komunal i Ferizajit është pa bazë ligjore dhe nuk e obligojnë Pastërtia të bëjë kompensimin e KKA-së dhe këto vendime nuk krijojnë efekte juridike dhe si të tilla nuk duhet të zbatohen. Në PVF të vitit 2016, si shpenzime operative ishin prezantuar 22,680€, të cilat kanë të bëjnë me kompensimin e KKA-se. Për më tepër këto pagesa janë kryer nga kategoria Mallra dhe Shërbime, dhe duke mos bërë përlogaritjen dhe pagesën për kontribute dhe tatime.

**Rreziku** Kompensimi i KKA-se pa bazë ligjore, sjell deri tek rritja e shpenzimeve të Pastërtisë. Gjithashtu, përfshirja e këtyre kompensimeve si shpenzime operative krijon pasaktësi në zërat e pasqyrave financiare. Për më tepër mos pagesa për kontribute dhe tatime dëshmon mos zbatimin e ligjeve të ATK-se.

**Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Pastërtia të veproj në përputhje të plotë me Ligjet e aplikueshme në Kosovë.

**Çështja 12 - Blerje e mallrave pa njoftim kërkesë dhe urdhër kërkesë për blerje - Prioritet i lartë**

**E gjetura** Sipas rregullores për procedurat e furnizimit dhe blerjes (neni 7 dhe 8), depoisti gjegjësisht zyrtari për prokurim duhet të përpiloj Njoftim Kërkesën për Blerje dhe Urdhër kërkesën për blerje, e cila duhet të aprovohet dhe nënshkruhet nga Kryeshefi Ekzekutiv. Në 21 raste kemi vërejtur se blerjet e mallrave ishin bërë pa njoftim kërkesë dhe urdhër kërkesë për blerje.

**Rreziku** Mos përpilimi i njoftim kërkesës dhe urdhër kërkesës për blerje si dhe mos aprovimi i blerjes nga Kryeshefi Ekzekutiv rrit rrezikun e realizimit të blerjeve pa kontrolle.

**Rekomandimi 12** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që të zbatohen procedurat për blerje të mallit dhe për çdo blerje të përpilohen dhe aprovohen njoftim kërkesa dhe urdhër kërkesa për blerje.

**Çështja 13 - Mos prezantimi i shpenzimeve të qirasë në Pasqyrën e të Ardhurave - Prioritet i mesëm**

**E gjetura** Pasqyra e të Ardhurave paraqet rezultatin financiar për një periudhë, si rezultat i ndryshimit të të hyrave dhe shpenzimeve. Në pasqyrën e të ardhurave Pastërtia nuk kishte prezantuar shpenzimet e qirasë në vlerë 6,200€. Kjo sipas tyre për shkak se ATK nuk pranon këto shpenzime pasi që ndërmarrja nuk ka paguar tatimin në burim.

**Rreziku** Mos prezantimi i shpenzimeve të qirasë në Pasqyrën e të Ardhurave, rezulton me nënvlerësim të shpenzimeve, rrjedhimisht kjo ndikon në pasaktësinë e fitimit/humbjes se vitit.

**Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që pasqyrat financiare përgatiten në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit, në mënyrë që të gjitha shpenzimet e vitit të prezantohen në PVF.

**3.2.3 Investimet kapitale**

Gjatë vitit 2016, Pastërtia nuk kishte realizuar asnjë investim kapital. Investimet e planifikuara nuk janë realizuar si rezultat i mos ndarjes së granteve nga MZHE. Planifikimi i tyre është bërë duke u mbështetur në supozimin se Pastërtia do të merr grant nga MZHE.

**Rekomandimi**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.3 Pasuritë

#### 3.3.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo qarkulluese në fund të vitit 2016 është 1,248,972€. Mbajtja e regjistrit përmbledhës të pasurisë në Pastërtia bëhet me program kompjuterik të kontabilitetit. Në regjistrin e pasurive janë evidentuar edhe pasuritë jo qarkulluese në vlerë mbi 1,000€. Ne u fokusuar të pasuritë e blera gjatë vitit 2016, për të verifikuar nëse ato ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe në regjistrin e pasurisë. Struktura dhe ndryshimet tek këto pasuri janë dhënë në tabelën me poshtë.

Tabela nr. 4 Pasuritë sipas kategorive dhe shumave në €

Përshkrimi	Toka	Ndërtesa	Pajisjet dhe Makineritë	Totali
Kosto historike (Vlera blerëse)	980,000	269,894	1,061,742	2,311,636
Zhvlerësimi i akumuluar (deri 2015)		130,608	932,055	1,062,663
Blerjet gjatë vitit 2016				
Rivlerësimi i pasurive	-	-	-	-
Zhvlerësimi i vitit 2016		13,495	78,319	91,814
Vlera neto në libra me 31/12/2016	890,000	125,791	51,368	1,157,159

#### Çështja 14 - Ndarje jo e qartë e detyrave - Prioritet i mesëm

**E gjetura** Pastërtia ka të punësuar zyrtarin e pasurisë i cili me përshkrim të vendit të punës bënë regjistrimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e pasurive, llogaritë amortizimin dhe vlerësimin, pranon dokumentacionin nga kontisti dhe pasi konstaton rregullsinë e tij, bënë regjistrimin nëpër kartela me shënimet e duhura. Gjithashtu, me të njëjtat detyra me përshkrim të vendit të punës është ngarkuar edhe kontisti. Kjo si pasojë e mos përcaktimit të qartë të përshkrimit të detyrave dhe përgjegjësive brenda Pastërtisë.

**Rreziku** Mos ndarja e qartë e detyrave mes dy zyrtarëve mund të rezultojë me një regjistër jo të plotë të pasurive, norma jo adekuate të zhvlerësimit të cilat mund të kenë ndikim edhe në prezantim jo të drejtë të pasqyrave financiare.

**Rekomandimi 14** Kryesuesi i Bordit përmes Kryeshefit Ekzekutiv duhet të bëjë një ndarje dhe përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësive dhe të sigurojë që zyrtari i pasurisë të bëjë regjistrimin, mirëmbajtjen dhe mbikëqyrjen e pasurive, duke mbajtur një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive.

### 3.3.2 Parapagimet

Parapagimet janë shpenzime për të cilat është bërë pagesë por që kanë të bëjnë me periudha të ardhshme të kontabilitetit. Ato tregohen në bilancin e gjendjes si pasuri. Vlera e parapagimeve në fund të vitit 2016 ishte 1,582€.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.3.3 Trajtimi i parasë së gatshme

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme në llogaritë bankare dhe arkë. Në fillim të periudhës raportuese gjendja e parasë së gatshme ka qenë 9,078€, ndërsa në fund të periudhës kjo gjendje ishte 27,453€.

#### **Rekomandimet**

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.3.4 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të Pastërtisë prezantojnë shuma të mjeteve që klientët i detyrohen Pastërtisë për shërbimet që i kanë përfituar prej sajë. Pastërtia ka prezantuar të arkëtueshmet në vlerë 1,985,960€, prej të cilave 16,552€ janë të arkëtueshme të krijuara gjatë viteve të kaluara të cilat punëtorët i obligohen Pastërtisë. Edhe pse gjatë vitit 2016 ishte zbatuar Ligji për Faljen e Borxheve Publike, të arkëtueshmet këtë vit tregojnë një trend në rritje në krahasim me vitin e kaluar për 115,847€. Kjo për shkak të politikave jo-efektive të zbatuara nga menaxhmenti dhe mungesës së një strategjie për inkasimin e këtyre borxheve. Mangësitë lidhur me menaxhimin dhe prezantimin e llogarive të arkëtueshme janë prezantuar tek nënkapitulli i Opinionit të auditimit.



---

**Çështja 15 - Provizionimi për borxhet e dyshimta - Prioriteti i lartë**

- E gjetura** Sipas Rregullores për Zbatimin e Procedurave dhe Politikave Afariste të Pastërtisë (neni 16) borxhi i cili është me i vjetër se gjashtë (6) muaj supozohet që është borxh i dyshimta. Pastërtia bën provizionimin e borxheve të dyshimta. Provizionimi miratohet paraprakisht nga Bordi i Drejtoresve me (%) përqindjen e provizionimit. Në PVF të vitit 2016, Pastërtia nuk kishte bërë provizionimin e borxheve të dyshimta ashtu siç parashihet me rregullore përkatëse.
- Rreziku** Mos provizionimi i borxheve të dyshimta rrezikon që Pastërtia planifikimin e saj për vitin e ardhshëm ta bazojë në të hyra të cilat realisht është vështirë për t'u arkëtuar. Gjithashtu mos provizionimi i borxheve të dyshimta nuk prezanton një saldo të sakte të fitimit në PVF.
- Rekomandimi 15** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që gjatë përpilimit të PVF-ve zbatohen rregulloret përkatëse, në mënyrë që të prezantohen të dhëna të sakta financiare.

## 3.4 Kapitali dhe Detyrimet

### 3.4.1 Kapitali

Në Pasqyrat Vjetore Financiare, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Përshkrimi	Me 31/12/2016	Me 31/12/2015
<b>KAPITALI:</b>	<b>2,537,168</b>	<b>2,170,553</b>
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezerve	2,506,719	2,088,447
Fitimet/Humbjet e bartura deri në 2015	57,106	45,188
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(51,656.5)	11,918
Rezerva e rivlerësimit	-	-

Mangësitë lidhur me ekuitetin janë prezantuar në nënkapitullin 1.2 Opinioni i auditimit.

### 3.4.2 Trajtimi i borxheve

Pasqyra e detyrimeve të papaguara të cilat janë obligime ndaj furnitorëve dhe Administratës Tatimore të Kosovës në fund të vitit 2016 ishte 754,488€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2017. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga Pastërtia të shqyrtuar më në detaje në nënkapitullin 3.3.

#### Çështja 16 - Mos prezantim i saktë i obligimeve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Në krahasim me shënimet kontabël vlera e detyrimeve të prezantuar në PVF ishte nënvlerësuar në vlerë prej 1,000€. Kjo për shkak të mos regjistrimit të disa faturave.
- Rreziku** Nënvlerësimi i detyrimeve rrezikon një prezantim jo të saktë të detyrimeve në PVF.
- Rekomandimi 16** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që prezantimi i obligimeve të jetë në harmoni me shënimet kontabël, në mënyrë që të prezantojë një vlerë të saktë në PVF.

## 3.5 Shënimet shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, japin informacion shpjegues të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

### Çështja 17 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese - Prioritet i lartë

**E gjetura** Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me pasuritë jo qarkulluese, zhvlerësimin e tyre, rritjet ose zvogëlimet;
- Prezantim jo i saktë lidhur me përbërjen e stoqeve. Sipas shënimeve kontabël vlera e stoqeve përbehet nga rezervat e kripës, rezervat e naftë dhe rezervat e vajit, ndërsa në shënimet shpjeguese rezervat e vajit ishin prezantuar si depoja e pjesëve rezervë;
- Informacione jo të sakta lidhur me llogaritë e arkëtueshme. Sikurse tek pasqyra e pozitës financiare edhe tek shënimet shpjeguese saldo e llogarive të arkëtueshme ishte prezantuar ndryshe nga shënimet kontabël; dhe
- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me rezervën e kapitalit dhe detyrimet.

**Rreziku** Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i shënimeve shpjeguese, rrezikon që PFV të mos japin një pamje të drejte dhe të vërtetë.

**Rekomandimi 17** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që gjatë hartimit të PFV-ve në shënimet shpjeguese të prezantohen informacione të detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë të sajë.

---

## Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

**Të prioritetit të lartë** - Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

**Të prioritetit të mesëm** - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

### Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Tatimet	Auditori rekomandon që Pastërtia të bëjë korrigjimin e formularit të CD vjetor për vitin 2014.	Është zbatuar plotësisht. Pastërtia kishte bërë korrigjimin e CD Formularit të deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave.		
Pasuritë	Pastërtia të ndërmarrë veprime lidhur me zhvlerësimin e mjeteve themelore sipas SNK-se dhe ATK-se.	Është zbatuar.		
Pasuritë	Të behet rivlerësimi i pasurive se paku një herë në 3 deri 5 vite.			Nuk është zbatuar.
Pajtueshmëri	Të hartohet rregullorja për procedura dhe udhëzime për zbatimin e kontrollit të brendshëm.	Pastërtia ka nxjerr dhe aprovuar rregulloren për zbatimin e procedurave dhe politikave afariste të sajë.		
Financa	Pastërtia të zbatoj procedurat që analizat mujore të bilanceve të librit kryesor të bëhen procedura rutinore.	Është zbatuar plotësisht. Zyrtari Kryesor Financiar përgatit raporte mujore të bilanceve të librit kryesor në drejtim të Kryeshefit Ekzekutiv.		
PVF	Plani kontabël, çmuarjet dhe gabimet të shpalosen mjaftueshëm siç kërkohet me SNK8.		Është zbatuar pjesërisht.	



Pasuritë	Ruajtjen e asetëve në kuadër të lokacioneve dhe objekteve.		Është adresuar pjesërisht. Pastërtia kishte angazhuar sigurim për objekte mirëpo jo edhe për vendosjen e rrjetave metalike për arkat.	
Mbrojtja e ambientit	Mbrojtjen e ambientit si për banoret e lokacionit dhe të punëtorëve në lokacion dhe objekte.	Pastërtia kishte angazhuar një kompani për Dezinfektim, dezinfektimi dhe deratizimin e objekteve dhe sipërfaqeve të jashtme në të gjitha njësitë e sajë.		

## Shtojca IV: Letër konfirmimi

KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
"PASTËRTIA" SH.A.  
Nr. 1240  
FERIZAJ 26.05.2017

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2016 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të KRM Pastërtia Sh.A., për vitin 2016 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Ilmi Statovci

Kryesues i Bordit të Drejtoreve

Data: ..... Prishtinë,  
26.05.2017

z. Dugagjin Etemi

Kryshef Ekzekutiv,

Data: ..... Prishtinë,  
26.05.2017

